



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, nenit 33 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa i Komunës së Klinës, bën këtë:

FTESË

Ftohen të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, të marrin pjesë në mbledhjen e VIII-të të KPF-së e cila mbahet me datë: 06.09.2023 në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në ora 09:00.

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i draft-buxhetit të komunës së Klinës për vitin 2024 dhe projeksionet për vitet 2025-2026 (ref.Drejt.Fin.),
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri (ref. Drejt.Fin.),
5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin korrik-gusht 2023,
6. Të ndryshme.

01Nr. 060-29965 2023
Klinë, më 28.08. 2023



Kryesuesi,
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Oslonjajući se na član 52 Zakona br.03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, član 33 Statuta Opštine Klina, član 15, 16 i 17 Pravilnika Rada Skupštine i Skupštinskih Komiteta, Predsedavajući Komiteta za Politiku i Finansije Skupštine Opštine Klina izdaje sledeće:

OBAVEŠTENJE

Obaveštavaju se svi članovi Komiteta za Politiku i Finansije da prisustvuju VIII-m KPFA dana 06.09.2023 u Sali Skupštine Opštine od 09:00.

DNEVNI RED

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka,
3. Razmatranje nacrtu budžeta opštine Klina za 2024 godinu i projekcije za 2025-2026 godine (ref.Dir.Fin.),
4. Razmatranje predloga-odluke za povećanje budžeta i izradu novog KODA (ref. Dir.Fin.),
5. Razmatranje podnetih zahteva Komitetu za Politiku i Finansije za mesec jul-avgust 2023 godine,
6. Razno.

01Br. 060-29965 2023
Klina 28.08 2023



Predsedavajući,
Fadil Gashi



Komuna e Klinës II

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KLINË
MUNICIPALITY OF KLINË
OPSTINA KLINË

Pranuar me dt. 08.08.2023
Pranuar në
Pranuar nga

Nr. i Udhës	Udhë	Shprehja	Vlera
Org. Jed.			Amount

01 351-26335/23

REPUBLIKA E KOSOVËS
AVOKAT
FISNIK(Y)MËRLAKU
KLINË

Tele: +383(0)49/534/962–E-mail: fisnikmerlaku@gmail.com, Rr. "Skender Rexhepi" nr. 47

KOMUNA E KLINËS
Asamblese Komunale

Nga: Nue(Zef)Kitaj, i lindur më datën 20.01.1981, në Krushevë e Madhe, Komuna Klinë, tani me vendbanim në, Krushevë e Madhe, Komuna Klinë, madhor shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit: 1009625409, dhe numër të ID: 0858257, të lëshuar nga MPB-së e Republikës së Kosovës, më datën: 19.10.2017, dhe i vlefshëm deri më datën 18.10.2027.

Lënda: Kërkesë për Dëmshpërblim.

Me anë të kësaj Kërkesë i paraqitemi titullit të lartëcekur, respektivisht, komisionit komunal për vlersimin e dëmëve, nga vërshimet e fundit, që t'i ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme, lidhur me dëmshpërblimin material-financiar, për parashtruësin Nue(Tomë)Kitaj, nga Komuna Klinë, më rastin e shkaktimit të demit, si pasoje rrymes, me datën: 02.06.2023, ne shtepine time ne fshatin Krusheve e Madhe Komuna Kline, ku si pasoje e rrymes mu eshte djegur pjesa me madhe e shtepise dhe demi eshte i konsiderushem material, të cilin dëmshpërblim, ligjërisht, dhe konform dispozitivave ligjore të LMD-së, kompetente është Komuna Klinë.

Më datën 02.06.2023, më rastin e shkaktimit të demit, si pasoje rrymes, parashtruësit Nue(Zef)Kitaj, i është shkaktuar dëm i konsiderushëm material, ku rryma e cila ka deportuar, brenda në shtepise duke djegur gjitha gjesendet materiale, ku të gjitha pasijet elektornike, dhe ekonomitë, familjare, janë djegur, brenda shtepisë duke bërë të pa banushme, të gjitha keto dëme të lartëcekura, kalojnë shumë mbi 7.000€€, fakt që provohet dhe vërtëtohet, edhe më daljen e komisionit komunal në vëndin e ngjarjës, dhe fotodokumentacionit qe gjindet ne kerkese, i propozojë, të bejë një vlersim të drejtë dhe objektiv, mbi dëmin e shkaktuar si pasoje e rrymes, duke pasur parasysh, dhe natyrën e demit emergjent dhe sa më parë që është mundur të



kompënzohëm financiarisht në xhirollogarinë: BPB, : 1303090003662217, në emër të parashtruesit Nue(Zef)Kitaj.

Mbetemi me shpresë që kjo kërkesë do të shqyrtohet pozitivisht nga komisioni komunal për vlersimin e dëmëve.

Kërkesës i'a bashkëangjesim keto dokumente:

1. Fotodokumentacioni,
2. Kopja e xhirollogarisë bankare.
3. Letërnjoftimi

Ne jemi ne pritje të përgjigjës suaj.

Më Respekt:

Parashtruesi
Nue(Zef)Kitaj, 20.01.1981,
Krushevë e Madhe, Komuna Klinë
Letërnjoftimi: ID 0858257
Nr. Përsonal: 1009625409, MPB/RK

Nue Zef







Për: Kryesuesin e Kuvendit komunal në Klinë z. Fadil Gashi

Lënda: Kerkesë për ndërtimin e ashensorëve në objektin banesor Rafi

Nga: Banorët e objektet banesor Rafi në Klinë

Në emër të banorëve Elmi Dushi




Kerkojmë nga Komuna e Klinës që të na ndihmojnë në ndërtimin e dy ashensorëve në objektin e ndërtuar pas luftës ku jetojnë 24 familje. Ky shqëtsim i banorëve është shprehur gojarisht tek ekzekutivi komunal nga banorët disa herë mirëpo nga komuna nuk ka pasur hapa konkret.

Kerkojmë nga Komuna e Klinës që të ndihmoj në realizimin e këtij projekti.

Presim përgjigje pozitive nga Komuna e Klinës.

044-222-846

Klinë, 20.7.2023





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

04-Nr. 401-29604 /2023

Klinë më dt: 25.08 /2023

PËR: Kuvendin e Komunës -Kryesuesit Z.Fadil Gashi.

PËRMES: Kryetarit të Komunës z.Zenun Elezaj,

NGA : Drejtori i Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim z.Enver Berisha.

LËNDA: Kërkesë për Për Shtim të Buxhetit me participim dhe kod të ri.



Duke u bazuar në Ligjin Për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin Për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin Për vetqeverisjen Lokale dhe Statutit të Komunës, kërkojm nga Këshilltaret Komunal qe të aprovojë vendimin Për Shtim të Buxhetit dhe Kod të ri më partcipim me fermerë.

Arsyeshmeria e marrjes se kësaj procedure qendron se Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit pas marrjes së kërkesës nga Drejtoria e Bujqësisë duke u bazuar në marrveshjet valide me fermerë, kërkon qe Kuvendi të aprovojë vendimin për shtim të buxhetit dhe krijim të kodit të ri.

.Pjesë përbërë e kësaj kërkesë është Propozim Vendimi.

Me respekt!



KUVENDI KOMUNAL KLINË

Më : _____/2023.

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) si dhe nenit 40.paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit Për Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17 38,60 dhe 61 Ligjit per Financa Publike dhe Pergjegjesit nr 05/L-1007 I ndryshuar dhe plotesuar nr.03/L-048 nenit 7 dhe 8 të Rregullorës Komunale Për Ndarje të Subvencione dhe Transfereve Nr 06-4043/2015 ,nenit 16 paragrafi 8 pika 8.2 i ligjit nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 nenit 92 të Statutit të Komunës, duke u bazuar në kërkesën e Drejtorisë së Bujqësisë, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim lëshon këtë:

PROPOZIM V E N D I M

PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KRIJIMIN E KODIT TË RI ME PARTICIPIM

1. Aprovohet vendimi për shtim te buxhetit, krijimin e kodit të ri- për ndërtim të serave për fermer në shumën prej: **13,197.92 € - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.**
2. Projekti i ri mund të krijohet me mjetet nga participimi i qytetarëve bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të komunës dhe komunitetit/qytetareve.
3. Komuna financon me mjete deri në shumën prej **30,797.08 €** kurse qytetarët kanë participuar me **13,197.92 €** vlere e tërësishme e projektit eshë **43,995.00 €.**
4. Projekti i ri Ndërtim te serave për fermerë 30% mbulohet nga mjetet e participimit me qytetarë kurse pjesa prej 70% do të mbulohet nga Komuna nga kategorinë ekonomike **Subvencione dhe transfere** te Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kodi i programit (47018).
5. Për arsye të participimit nga qytetarët në shumën fikse 131.98 € për një serë, ndryshimi në shumën në total prej 0.58 € që i takon 30% të participimit nga qytetarët paguhet nga komuna.
6. Për zbatimin e vendimit do të kujdeset Kryetari i Komunës, të cilin vendim e zbaton Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.
7. Ky vendim hynë në fuqi ,pas miratimit në Kuvendin e Komunës,sipas **(QRK)Nr.06/2023}** për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores **(QRK) Nr.10/2019}** Për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe të pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.
Emri i projektit:**Ndërtimin e serave për fermerët në Komunën e KLINES.**
8. Më Vendim njoftohen: Kryetari I Komunës, MAPL,Ministria e Financave dhe Transfereve, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Shërbimi I Kuvendit dhe një kopje në arkivë.

01-Nr. _____/2023.

Kryetari I Kuvendit

Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
REPUBLIKA KOSOVO
www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Nr.No. Et. 401-2023-5723

Data-Dat. 07.08.2023

Për/To/Za :	Kuvendin Komunal, Klinë
Nga/From/Od :	Kryetari i komunës - z. Zenun Elezaj
Përmes/Through/Preko :	Drejtorit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim
Tema/Subject/Subjekat:	Shqyrtimi i Draft Planit të Buxhetit Komunal të Klinës për vitet 2024-2026
Data :	7.08.2023



Të nderuar

Duke u bazuar në faktin se jemi në fazën përgatitore të aprovimit të buxhetit për vitin 2024 dhe projeksionin për vitet 2025-2026, ju dërgojmë Draft Planin e Buxhetit për vitet 2024-2026.

Kësaj shkrese ia bashkëngjisim :

- Draft Planin e Buxhetit Komunal të Klinës për 2024-2026.

Faleminderit!



Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa
01Nr _____/23
Klinë,dt: _____/23

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VII e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 14.07.2023, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, OSBE-në, drejtorë të drejtorive dhe të pranishmit.

Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-qershor 2023,
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit të jashtëm për vitin 2022,
5. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimit të auditorëve të jashtëm,
6. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i parë me qytetarë i mbajtur nga kryetari i komunës, më datë 26.06.2023,
7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa, për muajin qershor-korrik 2023,
8. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: Më lejoni të hap mbledhjen e rregullt të radhës së Komitetit për Politikë dhe Financa. Ne, rendin e ditës e kemi pranuar, e kemi një kërkesë të rendit të ditës, por fillimisht, Azdreni nuk është prezent me neve, ndërsa pjesa tjetër jemi prej gjashtë anëtarëve të KPF-së, ne mund të vazhdojmë me mbledhjen.

E kemi kërkesën prej Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Financa, që të hyjë në rend të ditës:
Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për bartjen dhe shpërndarjen e mjeteve nga të hyrat vetanake.

Unë po hap debat për rend të ditës, nëse ka dikush? Po, urdhëro , Valmira?

Valmira Krasniqi: Desha ta bëjë një pyetje për një kërkesë që e ka adresuar një qytetare e Klinës, për arsye shëndetësore, nga Ariana Banushaj. Ajo e ka dorëzuar më 23 qershor për ndihmë financiare, a mund ta di arsyen, pse nuk është në material?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: A është për ndihmë mjekësore? Ato shkojnë direkt te zyra e kryetarit edhe paguhen me subvencione, s'kanë nevojë të vijnë këtu.

Fadil Gashi, kryesues: Duhet të shikojmë, ndoshta zyra pritëse ende nuk e ka proceduar, te ne s'ka ardhur, krejt çka vijnë dokumente këtu i pranoni edhe ju, si unë si ju. Por, tash ose është orientuar gabimisht, ka shkuar diku .

A ka dikush tjetër? A po pajtoheni për rend të ditës, me këtë shtesën që e propozova, kush është për?

Me 6 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi, kryesues: Ne veç e arsyetuam, Azdrenin.

Pika 2 . Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush për procesverbal? Kush është për?

Me 6 vota PËR, asnjë kundër, u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-qershor 2023.

Fadil Gashi, kryesues: Është raport i rregullt që e bëjmë për çdo tremujor, fillimisht ndoshta drejtori na bën një prezantim, pastaj kishim hapur debat.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, kryesues!

Buxheti sipas SIMFK për vitin 2023, duke përfshirë edhe të hyrat nga grantet e brendshme dhe të jashtme, është 14,508,039.98 €, buxheti për këtë periudhë është më i lartë për 15.52% se

buxheti i vitit 2022. Granti Qeveritar është burimi kryesor i financimit të buxhetit komunal, ku pjesëmarrja është 80.49% në vitin 2023 (shuma 11,677,821.00 €). Në raport me vitin paraprak buxheti nga GQ është 13.74% më i lartë.

Buxheti nga të hyrat vetanake të komunës për vitin 2023 është shuma prej 1,373,774.00 € (9.47% e shumës së përgjithshme vjetore), krahasuar me vitin paraprak, kanë shënuar rritje prej 28.89 %. Grumbullimi i të hyrave buxhetore gjatë këtij gjashtëmujori kanë arritur shumën prej 815,238.34 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, të hyrat tatimore dhe jo tatimore kanë shënuar një rritje prej 10.62% që korrespondon me 78,248.53 € më shumë krahasuar me gjashtëmujorin e vitit paraprak. Buxheti nga THV të bartura të vitit 2022, gjatë periudhës janar-qershor 2023 është shuma prej 976,793.04 €.

Granti i donatorëve të brendshëm - Participimi i qytetarëve në shumën prej 31,332.12 €, në raport me vitin paraprak, buxheti nga ky grant është 18.49 % (shuma 26,443.62€) më i lartë se në vitin paraprak. Grante tjera të jashtme - Donacioni i jashtëm në shumën prej 18,341.33 €, mjete këto të grumbulluara për ndihmë ndaj të prekurve nga vërshimet. Granti i performancës në total është shuma prej 776,403.11 €, në periudhën janar-qershor 2023 i kemi të alokuara vetëm mjetet nga DEMOS, në shumën prej 426,739.48 €, ndërsa mjetet tjera në shumën prej 349,663.63 € janë zotuar nga MAPL. Shpenzimet për paga dhe mëditje gjatë këtij gjashtëmujori, shënuan shpenzimin prej 3,624,911.34 €. Ndikim në këtë rritje të shpenzimit ka pasur hyrja në fuqi e Ligjit të ri të pagave.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, drejtor? A ka dikush? Po, urdhëro, Tunë Deda?

Tunë Deda: Përshëndetje për ju, kryesues, për drejtorin dhe për gjithë të pranishmit!

Kur është në pyetje te plani financiar, unë desha ta shpreh një shqetësim që ndoshta nuk i takon kësaj pike të rendit të ditës; ka qenë një kafshim i gjarprit këtu në komunën tonë, edhe merre me mend, shtëpia e shëndetit nuk ka serum kundër kafshimit të gjarprit në këtë kohë, edhe e thash që në seancë është mirë me bërë një kërkesë ata edhe ne si asamble, me ndarë një shumë të mjeteve për sigurimin e serumit. Ajo çka është shqetësuese, dëgjova se në krejt Kosovën nuk ka, vetëm FSK-ja. Është jashtë kësaj liste, por, e kërkoj edhe ndihmën tënde kryesues, edhe të kryetarit edhe të angazhohemi për ta bërë sigurimin e serumit. Kjo për mua është shqetësuese, në këtë kohë, mos me pasur shtëpia e shëndetit, serum!

Fadil Gashi, kryesues: Po, urdhëro, drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Këtu dy gjëra janë që ne duhet t'i kemi para vetes: e para, nëse serumi është në listën e barnave që sigurohet nga ministria, dmth komuna nuk ka çka të bëjë, mund ta kërkojë por në njëfarë forme nuk mund të...e ende më keq nëse është në nivel Kosove, dhe e dyta, jam shumë i sigurt që nëse është në përgjegjësinë e Drejtorisë së Shëndetësisë në Klinikë, nuk ka mbetur për para kjo, se Drejtoria e Shëndetësisë ka fond të mjaftueshëm për barëra.

Tunë Dedaj: Unë nuk po kërkoj përgjegjësi, as prej Drejtorisë së Shëndetësisë, unë jam duke kërkuar zgjidhje! Nuk është me rëndësi a e ka për obligim qeveria apo nuk e ka, se ne kemi ndarë shpesh mjete për raste të ndryshme. Drejtoria e Shëndetësisë e dinë si ta bëjnë kërkesën, për ta siguruar ne si komunë do të thotë, serumi të gjendet në Shtëpinë e Shëndetit, kjo nuk është e

falshme, nuk ka as nëpër operatorë privat!

Fadil Gashi, kryesues: Kjo le që s'falet, po s'ka asnjë arsye këtu! Është mirë që, nëse ju e shihni, ne e ngrehim edhe në seancë, por kjo nuk mjafton, por me siguruar serumin, nuk është që e ka koston që s'mund ta përballojë as komuna, se kushtojnë lirë. A ka dikush tjetër? Po, Tunë?

Tunë Dedaj: Faleminderit shumë, drejtor, për informacionet. Po më duket që është pak shpenzim brenda 6 muajve 31% edhe mos ta lejojmë në fund, le të hapen tenderët me kohë, le të zgjidhet përfituesi me kohë, ka mundësi të ju shtyhet nëse nuk e kryen punën me rregull, m'i dhanë vërejtje, me ja ndërprerë punën. Ne në fund po e lëmë, e në fund nuk është mirë me e lënë.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, dikush tjetër? Nëse s'ka, a kalojmë në pikën e radhës?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-qershor 2023, me 6 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i raportit të auditimit të jashtëm për vitin 2022.

Fadil Gashi, kryesues: Unë po besoj që ju edhe ne e kemi pranuar raportin e auditimit, tash na ka ardhur edhe plani i implementimit të rekomandimeve që kanë dal prej këtij raportit. Nuk është shumë shpresëdhënës, sepse si duket për sivjet na ka humbur marrja e grantit të performancës sepse është i kualifikuar, por, sido që të jetë, ju i keni këtu. Siç e tha Tuna, mirë është me kohë se edhe këtu po dalin pastaj zyra e prokurimit me qenë pak më efikase, se shumica prej tyre po ka vonesa edhe në implementim, pastaj po t'i shkakton vonesat edhe në pagesa. A ka dikush për raport?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që raporti i auditimit të jashtëm për vitin 2022 të kalojë për shqyrtim në kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimit të auditorëve të jashtëm.

Fadil Gashi, kryesues: Edhe ky është një dokument që e obligon komunën me ju kthyer plani i implementimit po të këtyre rekomandimeve që dalin nga raporti, edhe këto barten në seancë të njëjtat, kështu që, a ka dikush te plani?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që plani për zbatimin e rekomandimeve të auditorëve të jashtëm të kalojë për shqyrtim në kuvend.

Pika 6. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i parë me qytetarë i mbajtur nga kryetari i komunës, më datë 26.06.2023.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, kryesuesi, z. Fadil Gashi, theksoi se bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, kryetari ka obligim mbajtjen e takimit me qytetarë dy herë në vit, ku para qytetarëve shpaloset puna e përfunduar dhe planet e investimit nga komuna dhe po ashtu, kemi obligim ligjor që procesverbali nga takimi me qytetarë i mbajtur nga kryetari i komunës të shqyrtohet në KPF dhe pastaj në kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të procesverbalit nga takimi me qytetarë i mbajtur nga kryetari i komunës, pa debat, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim në kuvend.

Pika 7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa, për muajin qershor-korrik 2023.

Kërkesa 1

Kërkesë e parashtruar z. nga Refki Gashi nga Klinë, për rregullimin e problematikës së truallit të kompleksi “Benita” dhe rregullimin e çështjes së kompensimit të dëmit ndaj qytetarit, i cili thekson: Kam bërë kërkesat në vijën e rregullt administrative për matjen e truallit në sipërfaqe prej 5 ari, prej të cilave 3 ari e 40 metra janë të përshkruara në ngastrën kadastrale numër P-71006024-00525-15, e cila evidentohet në Certifikatën pronësore, numër 768, ZK Klinë, si pronë shoqërore e Kuvendit Komunal në Klinë, ndërsa pjesa tjetër prej 0.01.60 ha, po ashtu, evidentohet në të njëjtën Certifikatë pronësore.

Trualli i përmendur ishte i lirë dhe qytetari i kishte bashkangjitur dokumentacionin e nevojshëm për ndërtimin e një objektit individual dhe personal afarist - banesor, duke i paguar taksat e nevojshme dhe pagesat e nevojshme për shfrytëzim të përhershëm për 500 m² (5 ari).

Sipas planit urbanistik të Komunës së Klinës, trualli i përmendur ishte tokë ndërtimore urbane. Dokumentacionin e gjeodezisë në pajtim me rregullativen komunale e ka punuar i ndjeri Selim Berisha, drejtor i gjeodezisë dhe gjeodeti Nysret Gashi, punëtor i kësaj gjeodezie, ndërsa pjesën e rregullatives urbanistike e kanë punuar punëtorët e atëhershëm të urbanizimit, Elez Lecaj dhe punëtori tjetër Nedelku.

Papritmas në hapësirat e këtij trualli ndërhyr Krasiq Milivoj, punëtor i pylltarisë, duke e pamundësuar vazhdimin e punës së qytetarit - paraqitësit të kësaj kërkesë. Refki Gashi, e rezervon të drejtën për marrjen e truallit të përmendur me krijimin e kushteve dhe rrethanave të volitshme në të ardhmen.

Paraqitësi i kësaj kërkesë ka paraqitur kërkesë me shkrim më 19.06.2006 për rregullimin e kësaj problematike të Organet Administrative Udhëheqëse të Komunës së Klinës. Edhe pse kanë qenë në dijeni edhe atëherë edhe tash, organet kompetente komunale e kanë injoruar kërkesën e qytetarit duke marrë masa dhe veprime në kundërshtim me interesin e qytetarit, duke i bërë atij dëm të madh.

Vlen të përmendet fakti se paraqitësi i kërkesës, qytetari - Refki Gashi, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë zyrtar administrativ, zyrtari i lartë i zgjedhur i Klinës dhe Kosovës. Prandaj këtu bëhet fjalë për një udhëheqës komunal të Komunës së Klinës dhe Kosovës, i cili ka punuar sa ka pasur Kosova Kushtetutë dhe puna e tij nga qytetarët dhe organet që ai i ka përfaqësuar është vlerësuar si histori e lartë suksesi.

Kuvendi Komunal i Klinës, kështu shkeli të drejtën e qytetarit të tij njëherë, mirëpo vazhdoi me shkeljen për të dytën herë duke ardhur si investitor i drejtpërdrejtë me kompaninë "Benita" dhe firmën "Citadela", duke kryer veprime ndërtimore në rrethinën e truallit të qytetarit, Refki Gashi, dhe të pjesës së tij, duke zhvilluar planin afarist - banesor, qendër e madhe tregtare me shumë blloqe, në koncesionin komunal 30 me 70, por qytetarin me lëndë shfrytëzim të përhershëm e lënë jashtë projektit, porse hapësirat e tij i shfrytëzon edhe sot e kësaj dite, duke i bërë qytetarit dëm të madh, edhe sot e kësaj dite pa i dhënë kurrfarë kompensimi.

Qytetari Refki Gashi, mendon se organet kompetente komunale shkallë - shkallë duhet të ndërmarrin masa dhe veprime urgjente, me qëllim të përmirësimit të padrejtësisë. Integriteti moral i qytetarit është i shenjtë, marrëdhënia e punës së qytetarit është e shenjtë, prona e qytetarit është e shenjtë dhe besoj se organet komunale do të reflektojnë pozitivisht me qëllim të rregullimit të kësaj problematike në marrëveshje me qytetarin.

Prona e dhënë në shfrytëzim në afat prej 99 vjetësh, ose afatgjatë, e largon qytetarin me lëndë në shfrytëzim të përhershëm duke shkelur detyrat punuese të gjeodezisë dhe urbanizmit se me rastin e rregullimit të zemrës së qytetit duhet të hartojë raport dhe të fillojë punën me qytetarin në fjalë. Këtu shkelet statuti i Komunës së Klinës, pika e 15-të, e cila i jep të drejtën qytetarit pjesëmarrjen e tij në vetëqeverisjen lokale me qëllim të marrjes së vendimeve për të qenë efektive në praktikë. Po ashtu, shkelet pika 38 e këtij statuti e cila tregon dritën e qytetarit në qasjen e dokumenteve zyrtare ku qytetari kishte lëndën e tij. Me informimin me lëndën e qytetarit, kuvendi do të kishte mundësi të gjente zgjidhje të drejtë dhe meritore. Vazhdon të shkelet Ligji për Vetëqeverisje Lokale, pika 55 e statutit të Klinës, ku Kuvendi i Komunës dhe akterët e tjerë me këto ngjarje, marrin vendime duke krijuar pasuri dobiprurëse për veten e tyre dhe partnerët e tjerë e në dëm të qytetarit - paraqitësit të kësaj kërkesë, me ç'rast shkaktohet konflikt i rëndë i interesit në dëm të qytetarit, Refki H. Gashi. Për qytetarin i cili paraqiti fakte dhe argumente respektivisht raport në këtë çështje, lënda përfundon kur drejtësia të vendoset në vend.

Fadil Gashi, kryesues: Në emër të KPF-së edhe në emër të kuvendit, ne duhet të ja kthejmë palës një përgjigje zyrtare dhe përgjigja zyrtare duhet me qenë aq e matur sepse çdo përgjigje e jona prodhon efekte juridike edhe është mirë të kërkojmë ndihmën edhe të Drejtorisë për Gjeodezi e Kadastër, me ardhur, me na plotësuar edhe njëfarë lloj elaborati çka ka të bëjë. Ka biseduar edhe kryetari me të, ka biseduar edhe me mua, ky ka lëndë edhe në gjykatë për të njëjtën çështje. Për atë po them, ne duhet me qenë të saktë, ne kur ta bëjmë përgjigjen me qenë të saktë edhe juridikisht po edhe duke ju referuar fakteve, argumenteve, edhe juridike po edhe faktike që janë në terren. Po, urdhëro, Tunë?

Tunë Deda: Kryesues, këtë rast, këtë problematik e di, se unë me Refkinë kam punuar para të 90-tës edhe është shumë e vërtetë që atij nga pushteti i atëhershëm, ju ka ndarë toka sikur krejt tjerëve se jua kanë ndarë. Ky e ka pasur edhe vendimin edhe gjitha, por, jam shumë i sigurt që ja kanë humbur, edhe unë e shoh që këtij djali ju ka bërë e padrejtë. Ju garantoj që kurrë s'kam biseduar me të për këtë rast, se kështu ka qenë, sikur banesat që i kanë ndarë atëherë, këtij nuk i kanë ndarë banesë po ja kanë ndarë pllacin. Unë obligohem ta them atë çka e di edhe është mirë me i ndihmuar.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Unë për vete po pajtohem me kryesuesin, që kjo lëndë të shkojë në kadastër dhe në zyrën ligjore.

Fadil Gashi, kryesues: Për dallim nga ti, ky nuk e përmend askund që ka pasur ndonjë dokument.

Tunë Deda: Ky në atë kohë më ka thënë se ka pasur, unë jam duke thënë çka më ka thënë ai dmth, para të 90-tës.

Fadil Gashi, kryesues: Tash ne i kemi dy variante: Varianti i parë, ne si Komitet me marr vendim e m'i thirr dy drejtoritë dhe me i marrë informacionet e nevojshme, duke ju bazuar në shkresa, dokumente, edhe me ja formuluar përgjigjen palës pa shkuar në kuvend, se ne veç e maltretojmë kuvendin se s'ka ndonjë material për kuvend.

Edhe njëherë, si KPF me kërkuar prej dy drejtorive, me kompletuar përgjigjen për palën edhe me na sjellë neve, edhe te unë si kryesues, dhe unë si kryesues me nënshkruar përgjigjen në emër të KPF-së dhe me ja dërguar palës, se ne s'kemi material ndryshe. Ata i kanë edhe shërbimet për çështje juridike, edhe i kanë gjeodetët, se tash unë edhe ju jemi të hendikepuar çka duhet m'i thënë, na ka referuar si dokument, statutin e komunës; të vetmin dokument këtë na ka sjellë, dmth statutin e komunës. A u pajtuam kështu, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Refki Gashi, duke marrë parasysh faktin se nuk posedon dokumente me të cilat dëshmon se prona ka qenë ndonjëherë e tij dhe lënda po ashtu gjendet në gjykatë, me 5 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi dhe Zyrën ligjore.

Kërkesa 2.

Kërkesë e parashtruar nga banorët, Binak Gashi, Xhemë Morina, Hamdi Morina, Shani Berisha dhe Faton Berisha, të cilët kërkojnë nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Klinës që të shikohet mundësia për caktimin e një sheshi në qytetin e Klinës, me emrin e heroit të kombit, Ali Ahmet Berisha.

Fadil Gashi, kryesues: Për këtë, si KPF ne s'mund të vendosim. Nëse pajtoheni edhe këtë e kishim drejtuar te Drejtoria e Urbanizmit, kurdo që e shohim ndonjë mundësi, vetëm ta keni

parasysh se ne, sot për sot, s'mund të vendosim as të caktojmë, se s'kemi ndonjë vend, s'kemi shesh, po ndoshta është mirë si KPF edhe kuvendi, me marr vendimin edhe me kërkuar te Drejtoria e Urbanizmit, kurdo që vjen ai. Urdhëro, Tunë Deda?

Tunë Deda: Po, kryesues, unë pajtohem me kërkesën e tyre, po unë e kam një propozim që do të ishte mirë, gjithë heronjtë, mos me e ndarë asnjë, me ja bërë një shesh të përbashkët, se kështu s'po ka vende. Është mirë me jua ndarë, po është e pamundur se s'ke ku të ja japësh, ata vyejnë me gjetur vet vendin, me thënë këtu na konvenon, se s'ke si!

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës për shikimin e mundësisë për emërtimin e një sheshi me emrin e heroit, Ali Ahmet Berisha, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet në Drejtorinë e për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe të shikohet mundësia që në të ardhmen të emërohet ndonjë shesh me këtë emër.

Pika 8. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për bartjen dhe shpërndarjen e mjeteve nga të hyrat vetanake.

Fadil Gashi, kryesues: Urdhëro, drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, kryesues! Realisht kjo procedurë e këtij vendimi për bartje është dashtë për herë të tretë me ardhur në kuvend, dmth njëherë që u morën mjetet nga ministria, herën e dytë kur u kthye, dhe tash për shkak te një procedure që është munduar një pagesë për sheshin që është rregulluar në qytet, me u kryer në kontratën dhe kodin e vjetër buxhetor, dhe kjo ka shkuar më herët në thesar, në ministri, po ata nuk e kanë pranuar dhe na kanë detyruar ne me hap kod të ri për këtë pagesë e që shuma e kësaj pagese është 68.920.000.00 euro. Pra, arsyeja pse është kthyer ky vendim për bartje është që, është anuluar vendimi që e kemi votuar herën e kaluar, dhe ne e votuam tash këtë bartje të re për shkak të një pagese që s'është kryer ende për sheshin, ky është ndryshimi.

Pika 9. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush? Atëherë unë ju falënderoj shumë për pjesëmarrje dhe për angazhim!

Procesmbajtësja,
Monika Palushi

KRYESUESI,
Fadil Gashi

REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA			
MINISTRI E BASHKËSIAVE DHE KOMUNITETEVE KOMUNITETI QËNDROR I KLINËS			
KËRKESË			
Emri i kërkuar		Data: 27/07/2023	
Adresa		Vlera e Vlerësimit	
Në emër të		Shprehja e Përkrahjes	
Në emër të		Vlera e Vlerësimit	
01 462-24614/23			

Drejtuar: Asambleja e Komunës së Klinës

Lënda: Kërkesë për shfrytëzimin e parcelës

P-71011030- 00116-0, Zona Kadastrale Drenoc, Klinë

Parashtrues i kërkesës: Gjevdet Fejza Prebreza

Nr. Personal [REDACTED]

Të nderuar,

Po e dorëzoj këtë kërkesë për marrjen në shfrytëzim të parcelës me numër P-71011030-00116-0, zona kadastrale Drenoc e cila gjendet para parces time me numer :

P-71011030-00117-3, parcelë në të cilën une kam dy shtëpitë në të cilat banoj me familje. Parcela gjendet para parces time në komplet gjatësinë andaj më duhet shfrytëzimi i saj për pastrim nga shkurret, mbjellje të drunjve dekorativ, hapësirë gjelbruese.

Shprehem i gatshëm që në rast të dhënies në shfrytëzim të kësaj parcele do jem i gatshëm të paguaj taksat sipas ligjeve në fuqi dhe që ta kthej prapë kurdo që kërkohet.

Poashtu zotohem në mirëmbajtjen në mos dëmtim të mjedisit brenda kësaj parcele.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DRAFT PLANI I BUXHETIT KOMUNAL I KLINËS

2024 – 2026

Gusht / 2023

Tabela 1: Financimi komunal për vitet 2024-20206 sipas burimit

Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026	Buxheti aktual 2023	Planifikimi 2024	Vlerësimi 2025	Vlerësimi 2026
Granti i përgjithshëm	5,458,575.00	6,086,118.00	6,539,536.00	6,965,571.00
Granti specifik i arsimit	4,481,266.00	5,453,128.00	5,616,721.49	5,785,223.00
Granti i shëndetësisë	1,577,980.00	1,673,212.00	1,756,872.00	1,844,716.00
Të hyrat vetanake	1,373,774.00	1,436,260.00	1,492,817.00	1,567,546.00
Totali :	12,891,595.00	14,648,718.00	15,405,946.49	16,163,056.00

BUXHETI I KOMUNËS SË KLINËS SIPAS KATEGORIVE TË SHPENZIMEVE PËR PERIUDHEN 2024 - 2026

Tabela 6. Korniza Buxhetore Komunale, në euro

Përshkrimi	2023 (buxheti aktual)	2024 (planifikim)	2025 (vlerësimet)	2026 (vlerësimet)
1 TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	13,051,595.00	14,648,718.00	15,405,946.49	16,163,056.00
1 Të hyrat vetanake	1,373,774.00	1,436,260.00	1,492,817.00	1,567,546.00
1 Grantet dhe transferet qeveritare	11,677,821.00	13,212,458.00	13,913,129.49	14,595,510.00
2 SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	13,051,595.00	14,648,718.00	15,405,946.49	16,163,056.00
2.1 Shpenzimet rrjedhëse	9,013,688.00	10,360,000.00	10,643,925.00	11,162,933.44
Pagat dhe medijtjet	6,753,688.00	7,893,500.00	8,030,925.00	8,432,471.25
Mallrat dhe shërbim	1,660,000.00	1,710,000.00	1,795,500.00	1,885,275.00
Shërbime komunale	200,000.00	250,000.00	262,500.00	275,625.00
Subvencionet	400,000.00	500,000.00	555,000.00	569,562.19
2.3 Shpenzimet Kapitale	4,037,907.00	4,295,218.00	4,762,021.49	5,000,122.56

Projektet me prioritet për vitin 2024

	Totali	10	21	
1	Projekte zbatuese	Mallëra dhe sherbime		
2	Ndërtimi i rrugeve dhe infrastruktures nentokesore në Klinë	250.000.00	200.000.00	50.000.00
3	Ndërtimi i parkut industrial për Kline	10.000.00	-	10.000.00
4	Ndërtimi i rrugeve e infrastruktures nentokesore në Cerovik-Qabiq	40.000.00	20.000.00	20.000.00
5	Ndërtimi i rrugeve (Trotuare) dhe infrastruktures nentokesore në Zajmë-Deiq	150.000.00	100.000.00	50.000.00
6	Ndërtimi i rrugeve e infrastruktures nentokesore në Klinë-Dersnik-Dolc	270.000.00	170.000.00	100.000.00
7	Ndërtimi i rrugëve dhe ures në Budisalcë-Rudice	50.000.00	20.000.00	30.000.00
8	Ndërtimi i rrugeve e infrastruktures nentokesore Videje-Polce-Pask-Jag-Krusheve e M.	120.000.00	80.000.00	40.000.00
9	Ndërtimi i rrugeve e infrastruktures nentokesore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	90.000.00	70.000.00	20.000.00
10	Ndërtimi i rrugeve e infrastruktures nentokesore Gllarevë-Rixheve-Stapanice-Zabergje	50.000.00	30.000.00	20.000.00
11	Ndërtimi i rrugeve dhe rindërtimi i rrugës Kline-Shtupel-Kërnice	150.000.00	120.000.00	30.000.00
12	Ndërtimi i rrugeve e infrastruktures nentokesore në Grabanicë-Bokshiq-Dollove	100.000.00	80.000.00	20.000.00
13	Ndërtimi i rrugeve e infrastruktures nentokesore në Gremnik	35.000.00	25.000.00	10.000.00
14	Ndërtimi i rrugeve e infrastruktures nentokesore në Jashanicë-Jelloc-Resnik-Pogragjë	130.000.00	80.000.00	50.000.00
15	Ndërtimi i rrugeve e infrastruktures nentokesore Siqevë-Ujmirë-Shtarice	65.000.00	50.000.00	15.000.00
16	Ndërtimi i kanalizimit në Shtupel-Kërnice-Binxhe-Grapce	80.000.00	60.000.00	20.000.00
17	Ndërtimi i rrugeve e infrastruktures nentokesore në Sferkë-Volljake-Qupeve	100.000.00	80.000.00	20.000.00
18	Ndërtimi i rrugeve e infrastruktures nentokesore në Qeskovë-Këpuz	15.000.00	15.000.00	-
19	Ndërtimi i rrugeve e infrastruktures nentokesore ne Ranoc - Leskoc	35.000.00	35.000.00	-
20	Ndërtimi i rrjetit te ujësjellësit në Komunen e Klinës	20.000.00		20.000.00
21	Bashkëfinancim me donatorë	465.218.00	315.958.00	149.260.00
22	Ndërtimi i liqenit akumulues për furnizim me ujë të pijes	120.000.00	80.000.00	40.000.00
23	Ndërtimi i shtratit te lumit Drini i Bardhë	70.000.00	70.000.00	-
24	Ndërtimi i shtratit te lumit Lumëbardhi i Pejës	80.000.00	80.000.00	
25	Ndërtimi i shtratit te lumit Klina	300.000.00	250.000.00	50.000.00
26	Ndërtimi shtigjeve te ecjes dhe infrastrukture rrugore ne Gryken e Jarines-Pogragjë	75.000.00	30.000.00	45.000.00
27	Ndërtimi i rrugeve dhe infrastruktures nentokesore ne Gjurgjevik i Madhë	50.000.00	50.000.00	
28	Ndërtimi i rrugeve e infrastruktures nentokesore ne Perqeve	20.000.00	20.000.00	
29	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Zllakuqan-Pataqan-Berkove	50.000.00	30.000.00	20.000.00

30	Asfaltimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Krusheve e Vogel	45.000.00	45.000.00	-
31	Studimi i fisibilitetit per ndertimin e ngrohjes qendrore ne qytetin e Klines	Mallëra dhe	shërbime	
32	Ndertimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore ne Poterqe-Dugajeve-Drenovce	100.000.00	70.000.00	30.000.00
	Urbanizmi	3.135.218.00	2.275.958.00	859.260.00
33	Ndërtimi i kanaleve te ujitjes	150.000.00	100.000.00	50.000.00
34	Shtrimi i rrugëve fushore me zhavor dhe pastrimi i rrjedhave ujore	Mallëra dhe shërbime		
35	Furnizim me mekanizem bujqesor per fermere	0.00		
36	Ndertimi i serave	0.00		
	Bujqesia	150.000.00	100.000.00	50.000.00
37	Mirëmbajtja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit	Mallra e shërbime		
38	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve)	90.000.00	70.000.00	20.000.00
39	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik	70.000.00	40.000.00	30.000.00
40	Rindërtimi I rrugëve me asfalt në Jashanicë dhe fshatrat tjera të Klinës	165.000.00	120.000.00	45.000.00
41	Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit	Mallra e shërbime		
42	Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit te Kamerave te qytetit	Mallra e shërbime		
43	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza	100.000.00	70.000.00	30.000.00
44	Riparimi i kanalizimit ne Komunen e Klines	Mallra e shërbime		
45	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Komunën e Klinës dhe mirëmbajtja e tyre	30.000.00	20.000.00	10.000.00
46	Mirëmbajtja e rrugëve	Mallra e shërbime		
	Infrastruktura rrugore	455.000.00	320.000.00	135.000.00
47	Furnizim me pajisje mjekësore	40.000.00	30.000.00	10.000.00
48	Ndërtimi i shtëpisë për persona të moshuar	150.000.00	50.000.00	100.000.00
49	Rindërtimi i objekteve shëndetësore	35.000.00	20.000.00	15.000.00
	Shendetësia	225.000.00	100.000.00	125.000.00
50	Shenjzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	Mallëra dhe shërbime		
51	Rrënimi i objekteve te vjetra dhe ndërtimeve pa leje	Mallëra dhe shërbime		
	Inspeksioni	-	-	-
52	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve komunale	30.000.00	30.000.00	-
53	Blerja e veturave zyrtare	35.000.00	20.000.00	15.000.00
54	Zhvillimi i softverit për menagjim të autoparkut	Mallra e shërbime		
55	Digjitalizimi i lëndës arkivore	Mallra e shërbime		
	Administrata	65.000.00	50.000.00	15.000.00
56	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve sportive e të kulturës	55.000.00	30.000.00	25.000.00
	Kultura	55.000.00	30.000.00	25.000.00
59	Rindërtimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive ne Komunen e Klines	210.000.00	160.000.00	50.000.00
60	Furnizim me inventar ne shkolla	Mallra e shërbime	-	-

Arsimi	210.000.00	160.000.00	50.000.00
Totali :	4.295.218.00	3.035.958.00	1.259.260.00

Projektet me prioritet për vitin 2025

		Totali	10	21
1	Projekte zbatuese	50.000.00	50.000.00	
2	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore në Klinë	230.000.00	150.000.00	80.000.00
3	Ndërtimi dhe sanimi i rrjetit të ujësjellësit në Komunen e Klinës	100.000.00	70.000.00	30.000.00
4	Ndërtimi i kanalizimeve në lagje të Klinës	70.000.00	50.000.00	20.000.00
5	Bashkëfinancim me donatorë	437.021.49	287.021.49	150.000.00
6	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nentokesore Videje-Polce-Pask-Jag-Krusheve e M.	100.000.00	80.000.00	20.000.00
7	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nentokesore në Klinë-Dersnik-Dollc	150.000.00	100.000.00	50.000.00
8	Ndërtimi i rrugëve (Trotaure) dhe infrastruktures nentokesore në Zajmë-Deiq	100.000.00	70.000.00	30.000.00
9	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Poterqe- Dugajevë-Drenovce	100.000.00	70.000.00	30.000.00
10	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Zllakuqan-Pataqan-Berkove	100.000.00	80.000.00	20.000.00
11	Ndërtimi i rrugëve dhe riparimi i rrugës Kline-Shtupel-Kërnice	150.000.00	100.000.00	50.000.00
12	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Volljakë-Sferke-Qupevë	150.000.00	100.000.00	50.000.00
13	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Qabiq-Cerovik	50.000.00	30.000.00	20.000.00
14	Asfaltimi i rrugëve Leskoc-Ranoc	50.000.00	50.000.00	-
15	Asfaltimi i rrugëve Ujemir-Shtaricë -Siqevë	80.000.00	60.000.00	20.000.00
16	Ndërtimi i rrugëve dhe ures në Budisalcë-Rudice	100.000.00	80.000.00	20.000.00
17	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nentokesore Gllarevë-Rixheve-Stapanice-Zabergje	60.000.00	40.000.00	20.000.00
18	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	100.000.00	70.000.00	30.000.00
19	Ndërtimi i shtratit të lumit Lumbardhi i Pejës	150.000.00	120.000.00	30.000.00
20	Ndërtimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë	180.000.00	150.000.00	30.000.00
21	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina	180.000.00	150.000.00	30.000.00
22	Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukture rrugore në Gryken e Jarines-Pogragje	100.000.00	80.000.00	20.000.00
23	Ndërtimi i parkut industrial për Kline	100.000.00	70.000.00	30.000.00
24	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nentokesore në Jashanicë-Jelloc-Resnik	150.000.00	100.000.00	50.000.00
25	Ndërtimi i kanalit kullues të ujit nga Gryka e Jarinës - Dersnik -Arbëri	150.000.00		

			100.000.00	50.000.00
26	Projekte për komunitete	20.000.00	20.000.00	
	Urbanizmi	3.207.021.49	2.327.021.49	880.000.00
27	Mirëmbajtja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit		Mallra e sherbime	
28	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve)	100.000.00	80.000.00	20.000.00
29	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik	100.000.00	80.000.00	20.000.00
30	Sanimi I gropave të rrugëve me asfalt	180.000.00	150.000.00	30.000.00
31	Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit		Mallra e sherbime	
32	Mirëmbajtja e rrjetit të Kamerave të qytetit		Mallra e sherbime	
33	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza	200.000.00	150.000.00	50.000.00
34	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Komunën e Klinës dhe mirëmbajtja e tyre	100.000.00	70.000.00	30.000.00
	Infrastruktura rrugore	680.000.00	530.000.00	150.000.00
35	Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve		Mallra e sherbime	
36	Rrënimi i objekteve të vjetra dhe ndërtimeve pa leje		Mallra e sherbime	
	Inspeksioni			
37	Rindërtimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive në Komunën e Klinës	210.000.00	150.000.00	60.000.00
38	Furnizim me inventar në shkollë		Mallra e sherbime	-
	Arsimi	210.000.00	150.000.00	60.000.00
39	Furnizim me pajisje mjekësore	80.000.00	80.000.00	-
40	Ndërtimi i shtëpisë për persona të moshuar	200.000.00	100.000.00	100.000.00
41	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve shëndetësore	30.000.00	20.000.00	10.000.00
	Shëndetësia	310.000.00	200.000.00	110.000.00
42	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve komunale	80.000.00	80.000.00	-
43	Blerja e veturave zyrtare	35.000.00	35.000.00	-
44	Digjitalizimi i lëndës arkivore		Mallra e sherbime	
	Administrata	115.000.00	115.000.00	-
45	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve sportive e të kulturës	80.000.00	80.000.00	
	Kultura	80.000.00	80.000.00	-
49	Ngritja e serave me participim		Subvencione	
50	Furnizim me pemë arvore me participim		Subvencione	

51	Ndërtimi i kanaleve te ujitjes	160.000.00	100.000.00	60.000.00
52	Fondi emergjent	Subvencione		
	Bujqesia	170.000.00	100.000.00	70.000.00
	Totali :	4.762.021.49	3.502.021.49	1.260.000.00

Projektet me prioritet për vitin 2026

		Totali	10	21
1	Projekte zbatuese	50,000.00	50,000.00	
2	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore në Klinë	200,000.00	150,000.00	50,000.00
3	Ndërtimi dhe sanimi i rrjetit te ujësjellësit në Komunen e Klinës	200,000.00	150,000.00	50,000.00
4	Rregullimi i shtratit te lumit Klina	180,000.00	130,000.00	50,000.00
5	Bashkëfinancim me donatorë	570,122.56	380,122.56	190,000.00
6	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nentokesore Videje-Polce-Pask-Jag-Krusheve e M.	100,000.00	70,000.00	30,000.00
7	Ndërtimii rrugëve dhe infrastruktures nentokesore në Dresnik-Dollce	150,000.00	100,000.00	50,000.00
8	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Poterqe-Dugajevë-Drenovce	100,000.00	70,000.00	30,000.00
9	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Zllakuqan-Pataqan-Berkove	100,000.00	70,000.00	30,000.00
10	Ndërtimi i rrugëve dhe riparimi i rrugës Kline-Shtupel-Binxhë	100,000.00	70,000.00	30,000.00
11	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Volljakë-Sferke-Qupevë	100,000.00	70,000.00	30,000.00
12	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Qabiq-Cerovik	80,000.00	60,000.00	20,000.00
13	Asfaltimi i rrugëve e infrastruktures nentokesore Leskoc-Ranoc	50,000.00	50,000.00	
14	Ndërtimi i rrugëve dhe riparimi i rrugës Kline-Shtupel-Binxhë	150,000.00	120,000.00	30,000.00
15	Ndërtimi i kanalizimit në Zajm	50,000.00	30,000.00	20,000.00
16	Asfaltimi i rrugëve e infrastrukture nentokesore Ujemir-Shtaricë -Siqevë	100,000.00	70,000.00	30,000.00
17	Ndërtimi i shtratit te lumit Drini i Bardhë	150,000.00	120,000.00	30,000.00
18	Ndërtimi i shtratit te lumit Lumëbardhi i Pejes	100,000.00	70,000.00	30,000.00
19	Ndërtimi i shtratit te lumit Klina	150,000.00	120,000.00	30,000.00

20	Ndertimi shtigjeve te ecjes dhe infrastrukture rrugore ne Gryken e Jarines-Pogragje	100,000.00	70,000.00	30,000.00
21	Ndërtimi i rrugëve e infrast. nentokesore Gllarevë-Rixheve-Stapanice-Zabergje	70,000.00	50,000.00	20,000.00
22	Ndertimi i parkut industrial per Kline	100,000.00	70,000.00	30,000.00
23	Ndërtimi i kanalit kullues të ujit nga Gryka e Jarinës - Dersnik -Arbëri	200,000.00	150,000.00	50,000.00
24	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	100,000.00	70,000.00	30,000.00
25	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nentokesore në Jashanicë-Jelloc-Resnik	100,000.00	70,000.00	30,000.00
26	Projekte për komunitete	20,000.00	20,000.00	
	Urbanizmi	3,370,122.56	2,450,122.56	920,000.00
27	Mirëmbajtja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit		Mallra e sherbime	
28	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara	100,000.00	70,000.00	30,000.00
29	Zgjerimi i rrjetit te ndriçimit publik	100,000.00	70,000.00	30,000.00
30	Riasfaltimi i rrugëve me asfalt	250,000.00	250,000.00	-
31	Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit		Mallra e sherbime	
32	Mirëmbajtja e rrjetit te Kamerave te qytetit		Mallra e sherbime	
33	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza	200,000.00	170,000.00	30,000.00
34	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Komunën e Klinës dhe mirëmbajtja e tyre	100,000.00	50,000.00	50,000.00
	Infrastruktura rrugore	750,000.00	610,000.00	140,000.00
35	Shenjzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve		Mallra e sherbime	
36	Rrënimi i objekteve te vjetra dhe ndërtimeve pa leje		Mallra e sherbime	
	Inspeksioni	-	-	-
37	Rindërtimi I objekteve shkollore dhe fushave sportive ne Komunen e Klines	210,000.00	150,000.00	60,000.00
38	Furnizim me inventar ne shkolla		Mallra e sherbime	-
	Arsimi	210,000.00	150,000.00	60,000.00
39	Furnizim me pajisje mjekësore	50,000.00	50,000.00	
40	Ndërtimi i shtëpisë për persona të moshuar	200,000.00	100,000.00	100,000.00

41	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve shëndetësore	30,000.00	30,000.00	-
	Shendetësia	280,000.00	180,000.00	100,000.00
42	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve komunale	60,000.00	30,000.00	30,000.00
43	Blerja e veturave zyrtare	50,000.00	20,000.00	30,000.00
44	Digjitalizimi i lëndës arkivore	Mallra e shërbime		
	Administrata	110,000.00	50,000.00	60,000.00
45	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve sportive	70,000.00	50,000.00	20,000.00
46	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve të kulturës	20,000.00		20,000.00
	Kultura	90,000.00	50,000.00	40,000.00
50	Ngritja e serave me pjesëmarrje	Subvencione		
51	Furnizim me fidane të pemëve të imëta: mjedër, dredhëza dhe manaferrë	Subvencione		
52	Ngritja e tufave të dhive me pjesëmarrje	Subvencione		
53	Furnizim me pemë arnore me pjesëmarrje	Subvencione		
54	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes	190,000.00	150,000.00	40,000.00
55	Fondi emergjent	Subvencione		
	Bujqësia	190,000.00	150,000.00	40,000.00
	Totali :	5,000,122.56	3,640,122.56	1,360,000.00